

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E HENE 14 SHTATOR 2023

Faleminderit, zonja Kryetare!

Së pari, si deputete e Shkodrës në këtë parlament gjej rastin të përshëndes hapjen e shkollës shqipe në Rrozhajë të Malit të Zi! E vlerësoj si një hap fort të rëndësishëm për të drejtat e shqiptarëve në vendin fqinj, ndërsa një falënderim i veçantë për këtë i shkon Kryeministrit të Malit të Zi, zotit Dritan Abazoviç! Për sa i përket marrëveshjes të paraqitur sot për diskutim e votim, është një përpjekje në fushën e sigurimeve shoqërore ndërmjet dy palëve, Shqipërisë dhe Malit të Zi, ku përfituesit më të mëdhenj janë bashkëkombësit tanë. Nga ana tjetër, edhe pse në relacionin shpjegues është pretenduar se marrëveshja është bazuar apo mbështetur në ekspertizën ndërkombëtare, përkatësisht në Rregulloren e Këshillit të Europës dhe Parlamentit European, neni 21 i kësaj marrëveshjeje mbetet i paqartë për sa i përket aspektit rregullues për përfitimet e sigurimit nën 12 muaj punësim. Rregullorja e Këshillit të BE-së jep përcaktime të qarta, sipas kategorive përkatëse. Rekomandimi ynë është fare i thjeshtë: të ndiqen hapat dhe modeli që tashmë BE-ja ofron. Sikurse ndodh përherë, propozimet e opozitës nuk merren parasysh nga përfaqësuesit e mazhorancës në komisione. Kam konstatuar se edhe në projektligjin që keni sjellë sot për miratim, nuk e keni reflektuar kërkesën tonë. Kjo tregon edhe një herë më së miri para opinionit publik sa të paaftë jeni në implementimet e ligjeve të këtij shteti. E treguat edhe në seancën e kaluar plenare, kur u ngutët për të emëruar si ministër një zotëri, të cilin ende nuk e kishit shkarkuar nga detyra e tij e mëparshme, duke rënë ndesh kështu edhe neni 103 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të nderuar bashkëqytetarë, edhe pse fjalën time e nisa duke falënderuar kryeministrin e Malit të Zi për dëshirën e mirë për të hapur një shkollë shqipe, dje në qarkun e Shkodrës ndodhi një tjetër fenomen, mbyllja e një tjetër shkolle.

Shpopullimi, ikja masive në emigrim e familjeve po bën që të zbrazen fshatra të tërë, pse jo edhe qytete. E pandodhur më parë, sepse ka 8 vjet që ky fenomen po shoqëron gjithsecilin prej nesh si deputetë, por falë këmbënguljes dhe protestës së disa prindërve në fshatin Mali Kolaj u bë e mundur që shkolla të qëndrojë dhe këtë vit e hapur. Ky nuk është vetëm një fenomen që ndodh rishtas, pasi ka 3 vjet që kërkesa e bërë nga disa mësues të qarkut të Shkodrës fle në sirtarët e Ministrisë së Arsimit. Këta mësues i janë drejtuar Ministrisë së Arsimit me një kërkesë legjitime, ku kanë shpalosur disa problematika në lidhje me mësimdhënien dhe nxjerrjen jashtë sistemit të mësimdhënies të shumë mësuesve në qarkun e Shkodrës. Ministria e Arsimit ka 3 vjet që nuk denjon as t'u kthejë përgjigje këtyre mësuesve. Po "haramin" e vitit 2019, që po e shndërroni si suksesin tuaj të radhës me ligjin e basteve, si do ta justifikoni në vitin 2023, si "hallall" para qytetarëve shqiptarë? Nuk ka parë ndonjëherë historia e këtij vendi qeveri më delirante e cinike, me të paaftë e injorantë në institucione, e zhytur në vjedhje. Kjo qeveri ka hyrë tashmë në historinë e shtetit shqiptar si më e korruptuara. Çfarë po bëni me taksën e pronës, një tjetër faturë në xhepat e shqiptarëve të thjeshtë, me taksimin që do të bëhet pa vlerësimin direkt të çdo prone, që do të rëndojë, pa dyshim, më shumë mbi të varfrit? Ky është një tjetër diskutim që do të bëhet këtu në Parlamentin e Shqipërisë, pasi të diskutohet edhe në komisione. Tashmë, ky Parlament ka dëshmuar se vetëm voton dhe asnjëherë nuk u kërkon llogari ministrave, të cilët po i drejtohen me radhë SPAK-ut. Sikurse mund t'i keni dëgjuar edhe herën e fundit, ata ish-ministrat tuaj dhe kryetarët e bashkive kanë filluar të zihen mes njëri-tjetrit edhe nëpër burgje.

Shokët e ngushtë të Kryeministrit tuaj, të cilët dilnin këtu dhe na shisnin moral neve opozitarëve, që nuk reshtëm asnjëherë së denoncuari me fakte dhe prova çdo aferë korruptive tuajën, një pjesë e mirë e tyre, që na shisnin moralin e të papërljerve, sot ndodhen pas hekurave. Ndaj, siç e thashë edhe pak më parë, ju keni hyrë në historinë e shtetit shqiptar si qeveria e grabitjes dhe e turpfit.